



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR.5

Datë 15.04.2026 ora 13 : 00 °°

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak me Nr.1443. Prot datë 10.04.2026, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.4, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 17.03.2026
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2026 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2026 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029.
- 6- Njohje me planin operacional vjetor 2026-2027, “Për administrimin e pyjeve dhe të kullotave të Bashkisë Rrogozhinë”.
- 7- Raport nga drejtoria e bujqësisë , mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe për gjendjen e rezervuareve në territorin e bashkisë Rrogozhinë.
- 8- Raport, mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” për vitin 2025 si dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2026.
- 9- Informimi i Këshillit Bashkiak mbi “ Parandalimin e Dhunës me bazë gjinore”
- 10-Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së grupit të djathtë znj. Silvana Aliu.
- 11- Informacion nga policia e shtetit mbi rendin dhe sigurinë publike në bashkinë Rrogozhinë.
- 12-Të ndryshme.
 - Shqyrtim i ankesës së një grupi qytetarësh mbi problematikën e kanalit e segmentit Peqin -Kavajë.
 - Shqyrtimi i kërkesës së z. F.Rexhepi.
 - Shqyrtim i kërkesës së tre subjekteve tregtare për dëmshpërblim nga përmytjet e Janarit 2026.



Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Erind Tosku, Shpati Kolgega, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Gezime Met-hasani, Altin Tosku, Lorena Baku, Mitat Daja, Besnike Coraj, Indrit Dedej, Silvana Aliu.

Kryetarja e këshillit znj. Mukades Gixhari i bashkohet online mbledhjes vetëm për shqyrtimin e pikës 3 të rendit të ditës.

Mungojnë :

Hekuran Xhani, Lije Dedej, Merilin Saraçi, Saimir Cani, Dhurata Meka, Sokol Gosa, Lulzim Hasa.

Kryetarja e këshillit znj. Mukades Gixhari merr pjesë online vetëm për shqyrtimin e pikës 3 të rendit të ditës.

Të ftuar :

1. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit.
2. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
3. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
4. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
5. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
6. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
7. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
8. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
9. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
10. Adriatik Lekaj - Përgjegjësi i zyrës së emergjencave civile.
11. Artur Kaja - Përgjegjës i sektorit të pyjeve.
12. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
13. Përfaqësues i policisë së shtetit.

Drejton mbledhjen :

Erind Tosku – Zëvendëskryetar i Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej



tyre, sipas axhendës ditore. Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, 11- Këshilltarë. z. Shpati Kolgega dhe znj. Besnike Coraj i bashkohen në vijim mbledhjes së këshillit , ndërsa kryetarja e Këshillit znj. Mukades Gixhari i bashkohet online mbledhjes vetëm për shqyrtimin e pikës 3 të rendit të ditës.

HAPET MBLEDHJA

Erind Tosku . Përsëendetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

-Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : Erind Tosku, Renato Kalemi, Fatmira Thartori, Enver Memolla, Alime Hoxha, Gezime Met-hasani, Altin Tosku, Lorena Baku, Mitat Daja, Indrit Dedej, Silvana Aliu.

-Lexojmë Vendimin me karakter individual që u mor në mbledhjen e këshillit të datës 17.03.2026 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar , si më poshtë :

Vendim nr . 14 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2026 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%

Vendim nr . 15 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2026 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr . 16 . Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2026 nga fondi i pushtetit vendor.

Gjithashtu lexojmë dhe verifikimin ligjor të ardhur nga Prefekti i Qarkut Tiranë për :

Vendimin nr . 17 . Për miratimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2026-2028.

Konfirmohet referuar ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe ligjit nr.64/2025 “Për barazinë gjinore”. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin zoti prefekt Shkëlqim Hajdari

Erind Tosku . Atëherë e hedhim në votim rendin e ditës. Hedhim në votim: të gjithë pro? Miratohet.

Miratohet me 11-vota pro pika 1 (parë) e rendit të ditës.



Miratimi i procesverbalit nr. 4 të mbledhjes së Këshillit Bashkiak, datë 17.03.2026, e hedhim në votim: pro, kundër, abstenim? Për miratimin e rendit të ditës?

Mitat Daja . Nuk jemi dakord që në fillim. Nuk kemi dakordësi. Po, nuk jemi dakord për arsye...

Erind Tosku . Vazhdo, më thuaj.

Mitat Daja . Arsyeja që nuk jemi dakord me rendin e ditës...

Erind Tosku . Po, patjetër.

Mitat Daja . Atëherë, e para e punës duhet të ndryshohet. Unë e kam thënë dhe e kam shkruar edhe te grupi i këshilltarëve që kryetarët e grupeve duhet të dakordësohen për kërkesat që bën një këshilltar, sepse në fund këshilltari është përfaqësues i qytetarëve, nuk është vetëm individ. Ju nuk e keni marrë fare parasysh këtë kërkesë, duke mos e reflektuar në mbledhje.

Erind Tosku . Kërkesa nuk bëhet në grupin e këshillit bashkiak, bëhet me shkresë dhe me letër zyrtare. Jo, po të them që e ke gabim.

Mitat Daja . Atëherë, unë kam dhënë dorëheqje nga kryetari i Komisionit të Konfliktëve para një muaji. Këshilli duhet të kishte miratuar një plan pune ose një kalendar punimesh, duke u konsultuar me të gjithë kryetarët e komisioneve dhe të grupeve të këshilltarëve. Kjo gjë nuk ka ndodhur dhe në këtë moment je në paligjshmëri kur vendos rendin e ditës sipas mendimit tënd.

Erind Tosku . Jo, e ke gabim.

Mitat Daja . Nuk e kam personale me ty, por me logjikën e punës. Nuk është bërë një plan. Unë kam qenë kryetar i Komisionit të Konfliktëve dhe nuk jam thirrur për të diskutuar planin e veprimtarisë së Këshillit Bashkiak. Vjet jemi mbledhur dhe kemi diskutuar prioritetet, këtë vit kjo nuk është bërë. Kërkesa që kam bërë duhet të ishte reflektuar në rendin e ditës. Nuk është reflektuar. Nuk jam dakord me rendin e ditës dhe besoj se edhe këshilltarët e tjerë janë në të njëjtën mendje. Rendi i ditës duhet të jetë: ndihmat ekonomike dhe problematikat e qytetarëve, si dhe raporti që kemi sjellë sot. Pastaj vijojnë të tjerat, nuk kemi ardhur këtu vetëm të dëgjojmë, por të reflektojmë problemet e qytetarëve.

Erind Tosku . Të kthej përgjigje.



Mitat Daja . Nuk kam mbaruar, më lër të përfundoj. Pastaj secili do të flasë. Ne duhet të merremi në konsideratë për problemet që ngremë, përndryshe nuk ka kuptim të jemi këtu vetëm për numër. Kaq kisha, rishikoni rendin e ditës.

Erind Tosku . Unë do të jap përgjigje për dy çështje në lidhje me rendin e ditës. Grupi shërben për koordinimin e problematikave mes këshilltarëve dhe qytetarëve, por kërkesa për futje në rendin e ditës nuk mund të vijë në ehatsapp. Vjen me emër, me procedurat ligjore.

Mitat Daja . Më nxirr procesverbalin ku ke bërë mbledhje me kryetarët e komisioneve dhe ke vendosur planin e punës së këshillit.

Erind Tosku . Kryetarët e grupeve dakordësohen për rendin e ditës, për datën dhe orën.

Mitat Daja . Plani i veprimtarisë së Këshillit Bashkiak miratohet nga kryetarët e grupeve dhe kryetarët e komisioneve.

Erind Tosku . Jo, e ke gabim. Lexoje mirë ligjin.

Mitat Daja . Si është miratuar plani i punës së këshillit?

Erind Tosku . Plani është miratuar nga kryetarët e grupeve.

Alime Hoxha . Është miratuar që në tetor.

Mitat Daja . Po bëj një pyetje.

Erind Tosku . Pyetja është e gabuar.

Indrit Dedej . Iku plani por kërkesa .

Enver Memolla . Për sa i përket programit të punës, ka qenë një mbledhje ku ke qenë i pranishëm me datë 19.11.2025

Mitat Daja . Jo, nuk jam thirrur fare.

Enver Memolla . Mbledhja është bërë dhe është diskutuar në pikën 11.



Mitat Daja . Nuk është diskutuar si duhet.

Indrit Dedej . Enver mbledhja e planit të punës ngeli pa u diskutuar.

Erind Tosku . Atëherë e hedhim në votim rendin e ditës. Hedhim në votim përsëri rendin e ditës dhe vazhdojmë me procedurë. Këto kërkesa nuk bëhen në ehatsapp.

Mitat Daja . Në rregull.

Erind Tosku . Zonja ka sjellë kërkesën me shkrim dhe është miratuar. Zoti Mitat thotë që nuk është dakord me rendin e ditës.

Silvana Aliu . E kemi pyetur nëse ka kërkesa për ta shtuar mos e publiko njëherë rendin e ditës të pyesim njëherë anëtarët e këshillit a kanë kërkesa.

Erind Tosku . Anëtari i Këshillit është i pavarur dhe e sjell vetë kërkesën s’do ta pyesësh ti...

Indrit Dedej . Jo, ne kemi grupe.

Indrit Dedej . Zoti nënkryetar, si këshilltar i opozitës, jemi dakord vetëm me pikat e ndihmës ekonomike.

Indrit Dedej . Për pikat e tjera nuk jemi dakord dhe nuk i njohim, pasi nuk kemi pasur informacion.

Indrit Dedej . Ne do të rrimë, por e dimë si do vazhdojë. Nuk jam dakort me rendin e ditës ...

Silvana Aliu . Muajin e kaluar ndërpreme mbledhjen 6pese nuk marrim informacion nga bashkia. Ju keni marë informacione që kemi 5-6 muaj që kërkojmë informacione ?

Erind Tosku . Po, patjetër.

Erind Tosku . Po, zonja Fatmira

Fatmira Thartori . I nderuar zoti kryetar, të nderuar këshilltarë , ne jemi sot këtu jo thjesht për të kaluar këto tre pika por dhe për dëgjuar këto dhe në qoftë së ato nuk na japin të dhëna ne ti kërkojmë ato që të na sjellin edhe më shumë mbledhjen tjetër. Nëse pezullojmë mbledhjen ne



nuk marim informacione. Duhet të miratojmë rendin e ditës dhe të kërkojmë më shumë informacion.

Silvana Aliu . Ke 3 muaj që i ke kërkuar dhe nuk i kanë sjellë. Pse na kërkon ti dëgjojmë kur ato nuk na kanë dëgjuar asnjëherë.

Indrit Dedej . Informacioni duhet të ishte me shkrim dhe i shpërndarë tek secili.

Erind Tosku . Po zonja Alime..

Alime Hoxha . Për kërkesat e Mitatit për rendin e ditës.

Indrit Dedej . Nuk janë të Mitatit janë të komisionit.

Erind Tosku. Komisioni nuk është në dijeni për atë raport, është vetëm firma jote aty..

Alime Hoxha . Plani i punës së këshillit është miratuar në dhjetor. Kryetarët e komisioneve kanë qenë këtu Ervis, ne e kemi bërë mbledhjen me kryetarët e komisioneve kush ka dashur me ardhur ka ardhur, kush nuk ka patur mundësi jo. Si për dakortësimin e planit të punës është bërë nuk kemi patur ndonjë kundërshtim që ... Pra plani i punës është bërë që në dhjetor dhe kush ka dashur me i bërë këto ndryshime ti sillte që atëherë... Megjithatë se kuptoj tek rendi i ditës keni problemin çfarë pikash janë futur apo nga renditja?

Mitat Daja . Renditja, sigurisht që renditja për atë po flasim..

Alime Hoxha . Kush është renditja?

Mitat Daja . Renditja është e tillë : ndihmat ekonomike , ankesat e qytetarëve , raporti i paraqitur, pastaj pikat e tjera .

Alime Hoxha . Ka një rregullore , sipas rregullores së këshillit bashkiak , kërkesat trajtohen në fund. Ne kemi patur gjithë vitin dhe gjithmonë kështu ka vijuar.

Mitat Daja . Kryetarët e komisioneve do të dëgohen sot ose secili në punë e tij .

Erind Tosku . Tani Mitat kalojmë tek pika 2 e rendit të ditës?

Mitat Daja . Tek cila?



Erind Tosku . Tek ndihmat ekonomike.

Mitat Daja . Për ndihmat ekonomike jemi ok .

Erind Tosku . Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, Miratim i procesverbalit Nr.4, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 17.03.2026. E hedhim në votim, pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 11-vota pro pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Erind Tosku . Pika 3: Miratimi i projektvendimit për ndihmën ekonomike për muajin shkurt 2026 nga fondi bllok 6% . Fjala për drejtorin e mbrojtjes dhe kujdesit social, zoti Ledion Hasani. Për pikën 3 kemi dhe zonjën Mukades Gixhari online që do të na bashkohet vetëm për këtë pikën e ndihmës ekonomike.

Ledio Hasani . Janë 7 familje përfituese dhe fondi është 28,000 lekë.

Erind Tosku . Ka pyetje?

Indrit Dedej . Jo nuk ka.

Erind Tosku . E hedhim nw votim. Pro, kundwr, abstenim.

Mukades Gixhari (online). Pro.

Erind Tosku . Të gjithë pro , miratohet.

-Miratohet me 12-vota pro pika 3 (tretë) e rendit të ditës.

Vendim nr .18. Miratohet me 12- vota pro, (1 votë pro, online nga kryetarja e këshillit znj. Mukades Gixhari) projektvendimi, i propozuar nga Nënkryetari i Bashkisë me Nr.1411.Prot datë 09.04.2026 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2026 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6%”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1411/1.Prot datë 09.04.2026.

Erind Tosku . Pika 4: Miratimi i projektvendimit për ndihmën ekonomike për muajin prill 2026 nga fondi i pushtetit vendor.



-I bashkohet mbledhjes këshilltari Shpati Kolgega në minutën e 16 të zhvillimit të mbledhjes.

Ledian Hasani . Janë 23 familje përfituese dhe fondi është 102,000 lekë.

Erind Tosku . Ka pyetje?

Indrit Dedej . Jo.

Erind Tosku . Atëherë të gjithë pro, miratohet.

-Miratohet me 12-vota pro pika 4 (katër) e rendit të ditës.

Vendim nr .19. Miratohet me 12- vota pro, projektvendimi, i propozuar nga Nënkryetari i Bashkisë me Nr.1412.Prot datë 09.04.2026, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2026 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.1412/1.Prot datë 09.04.2026.

Erind Tosku . Kalojmë tek pika 5.

Mitat Daja . Kalojmë tek kjo që them unë njëherë pastaj në pikën 5. Unë kam paraqitur një raport.

Erind Tosku . Do ti përmbahemi rendit të ditës ..

Mitat Daja . Atëherë unë i kam paraqitur këshillit një raport...

Erind Tosku . Nuk kalon dot në pika të tjera pa kaluar tek rendi i ditës.

Mitat Daja . Komisioni ka 5 anëtarë Mitat Daja , Shpati Kolgega, Indrit Dedej, Renato Kalemi, Altin Tosku dhe ka dërguar kërkesë për informacion në bashki.

Erind Tosku . Zoti Mitat !

Mitat Daja . Mos ndërprisni.

Erind Tosku . Të ndërpres sepse nuk e drejton ti mbledhjen e këshillit dhe ka një rend dite dhe duhet respektuar. Rendi i ditës është tek pika 5, Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e



tavaneve përgatitore të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm të bashkisë Rrogozhinë për vitet 2027-2029.

Shpati Kolgega . Meqë kemi ardhur se i bie të bëjmë mbledhje përsëri për të kaluar pikat...

Erind Tosku . Ku e din ti që do të dëgjojnë pikat e tjera, nuk të jep garanci Mitati, ai mbaron pikën e vet dhe ikën ...

Alime Hoxha . Ne e futëm në rend të ditës për kërkesën e Silvanës ...

-Disa këshilltarë largohen nga mbledhja.

Erind Tosku . Meqë nuk kemi kuorumin e nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 13 : 30^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 19 min ; 56 sek.

- Ky procesverbal i mbyllet në faqen **10 (dhjetë)**.

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera